



☰ Menu



HOME > NEWS

Njoftim për shtyp datë 11 Mars 2024

11 March, 2024 by **KL GjJ** in **NJOFTIME PËR SHTYP**

Sot, në datë 11.03.2024, Këshilli i Lartë Gjyqësor zhvilloi Mbledhjen Plenare të radhës, në të cilën shqyrtoi çështjet si më poshtë:

Këshilli miratoi vendimin për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin nr. 503, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj. {...}.



Më tej, Këshilli shqyrtoi dhe miratoi vendimin për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar , për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin nr. 499, datë 21.11.2022 të Këshilit të Lartë Gjyqësor, për kandidatin z. {...}.

Gjithashtu, Këshilli vendosi për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 252, datë 24.05.2023 të Këshilit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj. {...}.

Në përfundim, Këshilli miratoi listën e gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, një vlerësim, si dhe të gjyqtarëve që nuk kanë e nuk mund të kenë asnjë vlerësim, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet e Këshilit të Lartë Gjyqësor nr. 73, nr. 74, nr. 75, nr. 76, nr. 77, nr. 78, nr. 79, nr. 80, nr. 81, nr.82, nr.83, nr. 84 nr. 85 dhe nr. 86, datë 20.02.2024.

[Previous](#)

Njoftim për shtyp 13 Mars 2024

[Next](#)

Njoftim për fillimin e procedurës së verifikimit e plotësimit të kriterëve të kandidatëve për në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për ndihmës ligjor për vitin akademik 2024-2025, nga Komisioni i Përkohshëm

Publikime

